



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Prijmenjeno/Prodato Received/Delivery	25.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	6457/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.851/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.1060/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.22/2018 të datës 17.01.2018 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga në Prishtinë, kundër

organit të punësimit/Administratës Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.22/2018 e datës 17.01.2018 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike më datë 09.06.2017 ka lëshuar Autorizim për shpalljen e konkursit nga Administrata Tatimore e Kosovës për pozitën Inspektor Tatimor-INS.23.JP00028736. Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të këtij autorizimi, me datë 13.06.2017 ka shpallur konkursin për pozitën, "Inspektor tatimor (30) pozita" me numër reference INS/230/JP00028736, ndërsa në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Administrata Tatimore e Kosovës më datë 11.08.2017 ka publikuar njoftimin për Kandidatët e Suksesshëm, ndërsa rezultoni se ankuesja nuk është kandidat e suksesshme. Ankuesja kundër këtij njoftimi ka parashtruar ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Fillimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka bashkuar ankesat e ankuesve dhe më datë 22.12.2017 ka nxjerr Vendim A/02/547/2017 me të cilin ka shfuqizuar vendimin e nxjerre nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, duke e obliguar të njëjtin ti rishqyrtoj ankesat e ankuesve lidhur me këtë procedurë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 10.01.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/2018 me të cilin ka refuzuar ankesat e ankuesve, ndërsa ankuesja kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në bazë të Vendimit A.nr.22/2018 të datës 25.01.2018, ka aprovuar ankesën e ankueses duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 01/2018 të datës 10.01.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës dhe duke anuluar konkursin e lartcekur.

Administrata Tatimore e Kosovës, e pakënaqur me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimin A.nr.175/2018 ka refuzuar padinë e paditëses, ndërsa pas ankesës në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kjo e fundit përmes Aktgjykimit AA.nr.1060/2021 të datës 15.09.2022 ka aprovuar ankesën e Administratës Tatimore të Kosovës duke anuluar Aktgjykimin A.nr.175/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe duke e anuluar Vendimin A.nr.22/2018 të datës 25.01.2018 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e kthen ne rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:218/2018 të datës 17.01.2018 të ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimin A.nr.22/2018 të datës 25.01.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.01/2018 të datës 10.01.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Njoftimin e datës 11.08.2017 për kandidatët e suksesshëm; Konkursin e datës 13.06.2017 të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për pozitën Inspektor Tatimore 30 pozita; Aktgjykimin A.nr.175/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin AA.nr.1060/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në ankesë e dërguar nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me të gjitha dokumentacionet përkatëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka rishqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe duke u bazuar në Aktgjykimin AA.nr.1060/2021 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, dhe pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.22/2018 të datës 17.01.2018, **SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesat me numër A.nr.31/2018 e datës 23.01.2018 e ankuesit S. L-Gj, ankesa me numër A.nr.37/2018 e datës 26.01.2018 e parashtruar nga ankuesja F .D, ankesa me numër A.nr.60/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesja A.B dhe ankesa me numër A.nr.61/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesi Q.U dhe më datë 15.08.2022 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.616/2022 përmes të cilit ka aprovuar pjesërisht si të bazuara ankesat e ankuesve, duke ndryshuar Vendimin me Nr.01/2018 të datës 10.01.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe njoftimin për kandidatët e suksesshëm të datës 11.08.2017 të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për procedurën e rekrutimit për pozitën Inspektor Tatimor 30 pozita dhe duke e konstatuar që kandidatët që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit të largohen nga lista e kandidatëve të suksesshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, konstaton se meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit me numër A.nr.616/2022 të datës 15.08.2022, ka vendosur përfundimisht lidhur me konkursin me numër reference INS/230/JP00028736 për pozitën, "Inspektor tatimor (30) pozita", të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në këtë fakt vlerëson se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", rrjedhimisht më këtë vendim bënë përfundimin e procedimit administrativ.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.851/2022, datë 25/10/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.